

## Kontributi në Lamë t'Atdhetaris

Marin Sirdani

Per me muejtë me ëndë e me kuptue aq sa duhet kontributin e elementit katolik shqyptar në lamë t'atdhetaris, duhet me pasë para sÿsh gjëjen e kombit t'onë, si në pikpamje politike, ashtu edhe në pikpamje fetare qÿsh nder kohë të para të kris-tjanizmit e deri nder kohë t'ona. Lypet një traktim i atill pse çashtja kombtare shqyptare, si ka me u pá, ásh perherë në mâ të madhen lidhni me çashtjen fetare-katolike. Sikur flirtja e vjeter, thotë Shufflay, kje si një kufi në pikpamje besimi. Ktu kufizojnë sot katolicizmi, ortodoksizmi e islamizmi<sup>1</sup>. Ásh pra kjo një çashtje jo vetun e dobishme por e nevojshme me u skjarue mbi veprën qi zhvilluen në favor të komit pjestarët e njanës nder tri besime të respektueme prej Statutit të mbretnis s'onë.

Po në një pershím kohe aq të gjatë, ku duhen shvillue jo vetem ndodhít e rrethánat, por ndonjherë edhe situata e vendit, per mos me shkue teper gjatë, kemi me pershkruue vetem pikat qi vijnë me qítë mâ në shesh aktivitetin e katolikut shqyptar në lamë t' atdhetaris per rreth të sa shekujve deri në kohen e Turqve të Ri. Prej asajë kohe deri nder ditët e sodit kemi me e vijue në një numer tjetër të ksajë riviste.

Do dijt se qÿsh nder kohë të para të kristjanizmit edhe një numer i mirë shqyptarësh e mori mbrapa ket besim. Ky numer shkoi gjithnji tuj u shtue, kshtuqi në shekujt e parë të ktij besimi nder shum gjytete kjenë ngrehë seli ipeshkvnore si per tregim, - n' Amante (ngjat· Vlonë) në vjetë 344; në Shkoder, 392; në Matje, 392; në Durcë, 424; n' Apolonje, 431; në Byllis, 431; në Djokle, 451; në Vlonë, 458; në Skampa, 458; në Prezrend, 458; në Shurdha Sarda, 594<sup>2</sup>. Mbas rregullimit politikuer në shekullin të IV e të V, Salona e ba metropolija e Dalmacís, Shkodra / per krahinen Prevalis, e Durrci per krahinen e Epirit të Ri. Ipeskvijet e Iliris e t' Epirit duken shpesh në historin e shtatë shekujve të parë të kristjanizmit, e sidomos në historin e Koncileve, si antarë të fortë të fës katolike kundra erzive<sup>3</sup>.

Gjytetet prej Arbe (Rab) e deri në Vlonë ishin mje në të VII shekull nën influencen kryesore të Prendimit. Në ket pikpamje nuk shkaktoi farë shregullimi e damja e Perandoris Romake (395), mbas së cilës Dalmacija mbeti nën Prendim në sa Prevalitanja e Epiri me Lindje. As fakti, se në vjetin 535 ipeshkvijet e Prevalitanjes ran nën metropolin e Justinjanës së Parë, e prandej nën influencen greke, nuk shkaktoi ndonji pengim<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Shufflay, Serbët e Shqiptrët, fq. 122

<sup>2</sup> Thallöczy, acta et diplomata res Albaniae Mediae aetatis illustrantia. Vol. I, n' Index

<sup>3</sup> Thallöczy, v. e ç., vol. I, fq. 1-1-3, n. 2, 3, 14

<sup>4</sup> Shufflay, v. e ç., fq. 122.

Nder të gjitha ato vende, ku qýsh motit ishin nën influencen e Prendimit, krishtenimi mbajti një karakter latin. E mbajti ket edhe atëherë, kúr cari Leon Izauriku (732) dau Epirin e Ri e Prevalitanjen bashkë me Italin e Jugut prej kishës rromake, e i shtroi nën patriarkatin e Konstandinopolit. E mbajti edhe atëherë kúr u themelue kisha serbe autoçefale (1219). Ipeshkvijt e Dalmacís së Jugut e të Shqypnis së Veriut u bân pshtetje kryesore të Papës në luften e madhe kundra ortodoksizmit në Ballkan në kohën turke<sup>5</sup>.

Kjo lidhni kaq e vijueshme mbrrijti n' apogén e vet me Balshajt e me Gjergj Kastriotin, e shqyptarët nuk e dijen vedin kurr për ma “Shqyptarë” se atëherë kúr të gjith u vûn nën murojen e Fés Katolike<sup>6</sup>.

### **Rreziku i Bizantizimit**

Qýsh ndër kohët e para të kristjanizmit u perdorote në vendin t'onë, si gjuhë zyrtare, shtetnore e kishtarë, ku latinishtja e ku greqishtja: në Shqypnín e verit e në të mjesmen latinishtja me ndonji përjashtim, greqishtja në të jugut. Si ishin dy gjuhë zyrtare të kishës, ashtu ishin edhe dy rrite, ase mëndyrë se si me krye zyret fetare: rriti grek e rriti latin, por besimi ishte i njënjishem n'anekand Shqypnín.

Të damit e parë fetar në Shqypni ndodhi në shekullin e XI kúr për shkak të skizmes s' orjentit, qi dau kishen greke prej asajë të Romës fiset toske pergjithsisht iu pshteten kishës bizantine, në sa fiset gege i ndejen besnikë kishës së Romës. Kjo dasí i shkaktoi një dam të madh vendit t'onë jo vetem kahë feja por edhe kahë kombsjia, perse me ket dasí perfituen të huejt me luejt politiken e vet për dam të komit shqyptár. Me pasë një ide të kjartë mbi çashtjen në fjalë do kthye mendimi te situata politike e Shqypnis qýsh do shekuj perpara skizmes.

### **Rreziku i Sllavizimit**

Si dihet, kahë mjedisi i shekullit të VII, Herakliu i I, perandori i Bizantit, nziti serbët, qi enë ishin në Rumenin e sotshme, me u lshue në shpinë Avarve e me i qitë prej Ballkanit. Ktyne, si e çuen në vend dishirin e atij perandori, u kjenë lshue në shperblim, posë vendit qi prej tyne pat emnin Serbi, edhe Boznja, një pjesë e Dalmacjes e do vende në Prevalitanje. Prej këndeje shkuen ma vonë tuj u shperda neper vende tjera të Ballkanit, e trajtuen disa qandra nën kryesi të do krenve të quejtun prej tyne Zhupana. Deri në shekullin e XI kta zhupana u sundojshin krejt më veti, po atëherë njëfarë Stefan Dobrosław fitoi njëfarë të drejte mbi të tjerë, e i biri i tij Mikaeli (1050-80), mori titullin Kral, titull i cili i kje njëoftë prej Papës Gregorit të VII. Në ket kohë edhe Shqypnija e Veriut me një pjesë të Malit të Zi

---

<sup>5</sup> Shuflay, v. e ç., fq. 123.

<sup>6</sup> Thallöczy: Illyrisch-Albanische Forschungen. V. I., 208.

kishin një zhupan të vetin, i cili njoftoi sypranin e Mikaelit.

Mirëpo as në Shqypni e mesme e të jugut nuk vonoi e u furë një popull i ri, Bullgarët (861), të cilët mbas do kohe, si edhe Serbët, mueren sundimin e vendit, por, në Shqypni, u mbet Serbve, te e mbramja.

Me këto dominacjone elementi shqyptar shkoi tuj bjerrë për herë e ma fort, tuj u slavizue, e me gjith kryengritje, qi bân disa heresh për me u dalë doret, u duelen zakonisht të pá dobi. Por me gjith mní qi kishte një element me tjetrin ishte dishka qi deri diku i avitetë: besimi i perbashkët. Serbët, qi qýsh me të VII shekull ishin nën ndigjesë të Kishës Latine, në vjetë 1288 iu pshteten Kishës Greke. Ktj ndrrimit Shqyptarët qi gjindeshin nën reje të tyre nuk iu perkrahen pergjithsisht e kta vlefti për me e mbajtë mâ të gjallë dasin me ta.

Papët e Romës, për me i vu një pendë rrymës së bizantinizmit e slavizmit, e mos me e lanë me ba krejt të veten kudra kishës shqyptare, u kujdesen qýsh me kohë me çue nierz të zotët sidomos me kryesue selit krye-ipeshkvore të Tivarit e të Durrçit e me ngrehë qandrra mungarësh sa ma shum në vendin t' onë.

Në tjetër ânë edhe kryetarët e kishës greke, të perkrahen prej sundimtarve të Bizantit e të Serbis, me qandrra Ohrin<sup>7</sup> e Pejen shkuen tuj shkputë prej kishës katolike ku njanin e ku tjetrin djeçez<sup>8</sup>.

“Në metropolln e Durrçit (Shqypni e mjesme dhe e jugut), në të XIII e të XIV shekull, hypja e zbritja e influencës katolike, anasjelltas ortodokse, shkote paralel me ndryshimin e auktoriteteve politikore. Ndermjet Lindjes e Prendimit ndrrojshin mendim nierzt e mdhej civila, ashtû edhe ndrroheshin ipeshkvijt e njenit e të tjetrit besim. *Me gjith ket, lufta e gjatë e Papatit me Bizantin mbi vendin shqyptar, nuk muer kurr formë të këqia. Për fanatizem fetar nuk babej aspak fjalë: per kundrasi gjinden sheje, qi këto rise nuk i kanë rrejtë kurr pengimet fetare. Ka sheje të qarta të simbozës së paster ndermjet katolicizmit e ortodoksizmit*<sup>9</sup>.

“Bujarët e mëdhej shqyptarë përgjatë bregut t' Adriatikut ishin katolikë. Për permbrenda, kahë ana e Ohrit, ashtû edhe vetem në Krue, deri në t' ardhun t' Anxhovinve (1272), sundojte influenza greke. - Dekretet e Papës së vjetit 1319 të drejtueme, me rasë të kryengritjes së madhe kundra Serbve, kryetarve të familjeve princore të Muzakejve, të Matarangut, t' Arjanitve, të Blinishtve, të Jonimve, i quejnë “dilecti filii” edhe “viri catholici”<sup>10</sup>.

Intelektualt shqyptarë t' asajë kohe, pá se popujt kufitarë tuj perzie iden “Religion” me iden “Shtet” po ishin jo vetem anmiqt e katolicizmit në Shqypni, por edhe të kombit shqyptar, pse me ndjekë skizmen atëherë ishte rrezik evident me mohue edhe kombsin e me pranue kombsin serbe, greke a bullgare, i vune për

<sup>7</sup> Farlati, Illyricum Sacrum. I, 198-9

<sup>8</sup> Thallóczy, “Forschungen” fq. 197 në notë.

<sup>9</sup> Shufflay, Serbët e Shqyptarët, fq. 138.

<sup>10</sup> Schufflay, v. e ç., fq. 139.

ball kishen shqyptare, e me ket mjet luftuen e dikur duelen ngallnyesa. Shofim prandej se aty e mbrapa çashtja shqyptare e çashtja katolike shkojnë ngjitas, e mprojsat e kreshnikët e katolicizmit janë njherit edhe mprojsat e kreshnikët e kombit t'onë.

Nji nder mâ të parët mprojsa të ksajë ide kje françaskani, Gjoni de Plano Carpino, krye-ipeshkev i Tivarit (1248-1252), i cili sajoi “me perbâ me Shqyptarë nji qanderr të fortë të katoliçizmit në tokë shqyptare<sup>11</sup>”. Me ket program i doli ktij prelati me kthye në prehen të Kishës Katolike në vjetë 1250 disa djeçeze të Shqypnis qandrore<sup>12</sup>.

Sigurue vogilija se nuk ishin lshue doret, filluen me u marrë vesht njani me tjetrin, e nën prísí të disa krenve e të klerit, shkuen tuj u ba reaksjon mbas reaksjonit anmiqve të fés e të kombit. Me gjithkta mbretent e Serbís qi kishin qitë çeken me ba çmos e me shdukë çfardo pengimit qi muejtte me u ndalue slavizimin e nenshtetasve të vet, mbasi në vjetë 1282-1356 shtruen mbarë Shqypnín, shkuen tuj i randue perherë e ma fort Shqyptarët në fé e zakone deri sa në vjeten 1313 Uroshi i II me qellim me shkimë kombsin shqyptare dha urdhen me ndjekë të gjithë ortodoksin. Shqyptarët atëherë u mblodhen per rreth André Muzhakës, shqyptarit ma zemrakut e ma me randsi n' at kohë, e mbasi lidhen besë me Pilipin e Tarantit, qi zotnojte Durrcin, me Karl Abertin d' Anjou, mbretin e Maxharris, me Mladin Banin e Boznjes, e ngushtuen mbretin e naltpermendun në vjetë 1320 me u njoftë të drejtat e mos me i trazue ma në fé e zakone<sup>13</sup>.

Në kjoftë se n' at kohë aq kritike per kombin t'onë u ruejten nalt ndiesit kombtare i duhet dijtun fort edhe klerit katolik i cilli s'i u da popullit shqyptár në kurrnji rasë po me te mjeroi, me te luftoi, me te gzoj. Dy albanologa, nder ma kompetentat në ket landë thonë se .... në popullin shqyptár Barít e Kishës Katolike të ktij populli, para historiye, ruejten nalt ndiesit kombtare, ndersa ordokst mbeten ma fort indiferenta në pikpamje nacionare<sup>14</sup>. “Ata qi i bân ball furis greko-serbe-ortodokse,- shkruen Dr. Milan v. Sufflay - kjenë veterant e Kishës Katolike, Benediktint, të cilët, tuj ndertue kuvendet e veta jashta gjyteteve e në zemer të popullit shqyptár nder male pshtuen Shqypnín prej ortodoksizmit, si ma vonë Françeskajt e pshtuen prej islamizmit.

Ket të vertetë të patrandshme të veprimt të klerit katolik, din Zoti dhe e dishmoi në ndonji rasë edhe shtypi jonë Fletorja e Tiranës “Vullneti i populli” (v. I. Perjudhë e II, n. 2 (36). fq. 2, v. 1930) “*Veprimet e klerit katolik per atddhe janë aqë të vjetra sa áshit robnija e kombit t'onë deri në ditën e Indipendecës*” - e nji tjetër e të njajtit gjytet (Ora. n. 30) dishmote se: ... *shkronjësi i këtyne radhve është i bindur dhe fort i gëzuar*

<sup>11</sup> Thallöczy, “Forschungen” v. I, fq. 202.

<sup>12</sup> Thallöczy, Act. et dipl. v. I, fq. 69, n. 200.

<sup>13</sup> Thallöczy, Act. et dipl. v. I, fq. 194-6, n. 648-650.

<sup>14</sup> Forschungen, fq. 275

*që të shpallë an-e-kand që Kisha Katolike është e vetmjaia organizatë fetare në Shqipëri e cilla ka përmbajtur gjithnjë të gjalla traditat shqiptare edhe pasë roberimit të Shqipëris!*"

\*\*\*

## Perandoria e Balshajve

Levisjet shqiptare për me u emancipue prej Serbve deri me deken e Car Stefan Dushanit duelen pá fryt e vetem vjeften për me mbajtë gjallë ndiesit kombtare, por me deken e tij (1355), qeveritarët e krenët e vendit që kishin pasë sundue n'emen të tij u deklaruen princa e dukë në veti. Nji nder kta Zotn që i dha mâ të madhin të trandun perandoris serbjane kje nji kryetar shqyptár i Balesit<sup>15</sup>. Ky, porsa diq perandori i naltpermendun bân për veti Lekët e Malícis<sup>16</sup> e msyni Shkodren, e mbasi qiti prej atij gjyteti Serbët e antarët e tyne, mori qeverimin e vendit e u çfaq dukë në veti<sup>17</sup>. Për me shkputë çdo lidhni me Serb e për me bashkue Shqyptarët jo vetem politikisht por edhe fetarisht, si edhe për me fitue simpatin e popujve katolikë t' Europës, Dukë Balsha i I me të bijt, që ishin ortodoks, në vjetë 1368 i derguen Papës urbanit të V, ipeshkvin e Shasit, për me e lajmue se kishin kthye në prehen të Kishës Katolike me nji shumsi populli<sup>18</sup>. Shqyptarët të dishruem për liri, mzi që priten e u bashkuen me at Dukë, e si në protestë të zotnimit të Serbve ata që paten marrë ortodoksin kthyen në katoliçizem. I biri i tij, Gjergj Balsha i I, tuj ndjekë programin e t' et, mbrrijte jo vetem Gegnin e Tosknin, posë Çameris, por edhe krejt Malin e Zi, nji pjesë të Dalmacís, deri në Selenik e Trau, e nji pjesë të madhe të Maçedonis. Me fjalë tjera ky ngjalli perandorin ilirjane të dikurshme, e mprojtí Shqypnín prej të huejve, tuj vu përpara Serbët, Boshnjakët, Napolitanët, Bullgarët e Turqit.

Qýsh me keto kohë e deri që kje pushtue dheu i jonë prej Turkut, e edhe atëherë shumica deri me 1640 Shqyptarët të thuesh mbarë, ishin katolikë ku me rritim latin e ku me rritin grek, e vetem në Dibren e Siperme ishin edhe Bullgarë ortodoksa e Shqyptarë perzietas<sup>19</sup>. Biemmi, tuj folë për Svetigradin thonë: "*Mirrte mbraþa ky popull besimin e krishtenë, por të prishun prej erezive, e jo mbas dogmave të Kishës Romane, që ishin besue prej Shqyptarve*"<sup>20</sup>. Ky persuazjon, se Shqyptarët mbarë janë katolikë, ase kisha e Shqyptarit është kisha katolike, i mbetun prej atyne kohve neper Slav ngjati deri vonë. Emzot Pjeter Bogdani në në vjetë 1685 (Cuneus Prophetarum) në parathanje shkruen se Shkiet, për antonomazi<sup>21</sup> fës katolike i

<sup>15</sup> Sirdani besonte se Balshajt vinin prej Balesit, një vend afër Rrjollit të Malsisë së Madhe. Por sot ka edhe bindje e argumente të tjera. Disa herë këto argumente përkohjë me prejardhjen e studjuesit; por ka edhe të tjera.

<sup>16</sup> Në këtë tekst, është hera e parë që argumentohet se marrja e Shkodrës prej Lekëve është shenjë fuqie ndër shqiptarë, e veçsisht Shqipnisë Veriperëndimore. Kështu, mosaftësia e Lekëve me ua marrë Shkodrën Turqëve në vitin 1911 as komunistëve në vitin 1945, ishin shenja se Shqipnia ishte e dobët.

<sup>17</sup> A. Degrand, Souvenirs de la Haute-Albanie, fq. 182. Paris, 1901.

<sup>18</sup> Balesi, motit gjyhet me seli ipeshkvore. Gjindet rranxë malit *Maranaj*, lerg shkodre nja 10-12 kilometra. N' at vend tash s'kan mbetë veç do rrenime në kshjtjell, e muret e njaj kishë që quhet "Kisha e Balesit".

<sup>19</sup> Barleti, Historia de Vita et Gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis, Libr. V, fq. 141.

<sup>20</sup> Istoria di Giorgio Castrioti detto Scander-begh, lib. III, fq. 192.

<sup>21</sup> antonomasia - zëvendësimi i një epiteti e mbiemëni për një emën njeriu, vendi a gjaje.

thonë “Arbanaska vera”.

“Ipushkviijt e Krues e Krye-ipushkviijt e Tivarit luejten një rrol të madh në gjysen e parë të XIV qindvjetë si nder perpjekjet për bashkimin me kishen serbe, ashtu edhe nder kundërshtimet e hapuna ndërmjet të mbretëve serb e të papës e nder projektet për luftën e Kryqtarvet.

Por të huejë, që nuk e shifshin 'në sy të mirë një përparim aq të madh të Shqyptarve, u lidhen ndërshej vedit e bân çmos deri që u duel me e shpartallue at perandori. Kshtuqi me deken e Balshës së III, 1422, mund të thohet se ajo perandori mbaroi, e vendet që përshijte ajo u dan ndërmjet të feudalve shqyptarë.

Dobit që i rrodhen Shqyptaris prej familjes balshjane kshtu i përmbledhë Fan Noli në historin e vet: “Përkundër, se jo vetem i dha Shqiperisë dy çliranjës të shkëlqyer, si Balshen I dhe Gjergjin e I, që zgjuan në zemer të kombit spirten e independencës, me ndjenjen e forcës së bashkimit dhe shijen e liris kombëtare, po i lanë si trashigim dhe Kishen Katholike, e cila i solli mprojtjen e Papës dhe perkrashjen e fuqive Katholike të Prendimit, mbi të cilat u pshtet më vonë Skanderbegu për të nisun fushatën e tij të paharruarshme<sup>22</sup>.”

## Shfaqja e Otomanëve

Mbas pak kohe që u tokoi Shqyptarve me e shijue lirin kombtare, pse u shduk rreziku i slavizmit e i bizantinizmit, iu pertrij një rrezik i ri e shum ma i damshem. Ky rrezik u vijte prej Turqve Osmanllij, të cilët në ket kohë ishin tuj u furë aty-ktu neper dhena të Balkanit. Kahë mbarimi i të XIV shekull (1389), Turqit u shtrijn kah ana e Serbis, edhe në një luftë të madhe në fushën e Kosovës, afer Prishtinës, luftuen me Serb, të cilët ndimoheshin edhe prej një ushtrie shqyptare nën Balshen e II. Mbas ksajë lufte Balsha i II u kthye me Shqyptarë në vendin e vet, po edhe atje e ndoqen Turqit e i moren Kosturin, Beratit, Shkodern e Drishtin. Ktu e mbrapa gjytetet shqyptare shkuen tuj ndrrue zot shpesh e shpesh, e levizjet u bân gjâ e zakonshme<sup>23</sup>.

## Aleanca Venete

Të trembun prej ktij rreziku të ri feudalët shqyptarë tuj mos i pá gjasen me i ba ball veças, u ngushtuen njëni mbas tjetri me kerkue perkrashjen e Republikës Venete, e cilla ishte atëherë e vetmja që dukej se muejte me u matë me Turk. Kjo republikë u epte fuqit e i nzitëte shpesh princat shqyptarë me i ba ball Turkut, por

---

<sup>22</sup> Historia e Skanderbuët. fq. 40

<sup>23</sup> Shufflay, Serbët e Shqiptarët, faqe 15, difton se qësh meketkohë populli shqyptar u vù në një dindje që vijon për disa shekuj. Një shumicë u venduen në dukatin e Athinës (1387), në Argolidë e në Napulí (1380); për këndej në ishullin Negropante e më vonë (1550) në ishujt e tjerë të detit Egjë.

Sulmi i parë turk (1387) shkaktoi një lvisje të madhe në Shqyptarin e Verit. Në senatin e Raguzës u bisedue në mojin e Gushtit 1388 mbi shqyptarë të aratisun (faciendi libero relaxari omnes Albanenses fugientes captos per nostros).

Në at vjetë, në mojin e Majit, muer vendim qeveria e Venedikut për të arratisun prej viseve të rrethit të Durrëcit.

ndonji herë kúr s' i shifte gjasen e qindresës e kshillote me ba pagjë me ta. Më sa tjera herë as në ket shteg kleri nuk u struk më një rrezik kaq të madh, por ku me princa, e ku me popull i qiten pengim mbas pengimit zgjanimit të Turkut. Meriti-min mâ të madhin qi u bashkuen Koja, duka i Dêjës, e Dimiter Jonima, kundra Turkut në vjetë 1401 e pat françeskani Magister “Nicolaus de Scutaro”; e në vjetë 1405 shkasin mâ të madhin me e qitë ushtrin turke prej Shkodre e dha një françeskan tjetër “Frater Franciscus de Scutaro<sup>24</sup>.”

### Vasalizimi i Princave Shqiptarë

Nën kercnimit turk as ndima e Venedikut n' at kohë nuk vjefti aq perse në vjeten 1410 prej friget mos të bjerrin tregun u lidh me te me i dhanë një tribut per vendet qi kishte në Shqypni. Princat shqiptarë atëherë s' i pán pshtim vetit veç me njoftë sypranin e Sulltanit, e per siguri se do t' i rrijshin besnikë e do t' i paguejshin tributin me rregull, pranuen me lanë neper kshtjelle të veta ushtarë turq, per ndryshej mbetshin të lirë me qeverisë mbas kanunit e zakonit të vendit. Me gjithkta, populli, e disa herë edhe princat vetë, qi s'muejshin me pá ushtrin turke nder vende të veta, u bashkuen e i qiten jashtë, e kshtu u shkaktuen lufta të parrashme ndermjet Shqyptarve e Turqve, e si dishmon Gjon Muzhaka (Muzaka, Ilopt, fq. 274), s' *kishin mbetun vetem pleqt, se të rijtë ishin vra të thuesh të gjith nder lufta kundra Turkut.*

\*\*\*

### Gjergj Kastrioti

Kshtu ishte gjeja e Shqypnis kúr në vjeten 1443 Skanderbegu prej robnije kthehej në vendlemje. Ky “Defensor fidei” e “Athleta Christi”, i bazuem në programin “Fé e Atdhe” permbloodhi edhe një herë, si parandej Balshajt, Shqyptarët më një, kren e vogjli.

Skandarbegu, thotë Baldacci<sup>25</sup>, *tuj i dalë zot fës së të Parve të vet, keje ma i pari qi i bani Shqypnin me u njoftë prej botës mbarë, në mënyrë qi çashtja kombtare-shqyptare áshht në mâ të madhen lidhni me çashtjen fetare*. E njimend nën prísí të tij, per nijzet e kater vjet, katoliku shqyptar e bani deken si me le: tuj u perla me ushtri të panjehuna të Turkut, të prime prej generalave mâ të mirve e deri prej Sulltanave: mâ teper, vûni perpara njijheri dy shtetet mâ të mdhat e asajë kohe, Turkun e Venedikun. Kshtu, si shprehet Barleti, u dukshin të pertrijme edhe një herë kohët e lumnueshme të Burrit e të Lekës<sup>26</sup>.

<sup>24</sup> Thallöczy (Acta dipl.) vol. II. fq. 240, n. 776

<sup>25</sup> “L'altra Sponda” Anno X, n. 1 fq. 2.

<sup>26</sup> Prodhimi mâ hyjnuer i ksaj race vdekje-prûse, i ksajë race luftare mâ të tmershme, shkruen Shufly (v. e ç., fq. 195), kje gjergj Kastriot Skanderbeu.

Ky, edhe për së gjalli u madhnue prej Europës prendimore me legjenda të ndryshme burmie. Paragjykim, se Skanderbeu kishte fuqí djallore, i báni Turqit me besuem edhe mâ teper në kismet. Fantazija e popujve të Ballkanit krijoi prej tij, kreshnikun e vjer-shave e të prallave të bukra qi ká.

Historjakët e vjeter të Shqypnis e pershkruejn me kto fjalë entuzjazmin e popullit shqyptár t' athershem: “Shprehje gzimi e shendri' u ndieshin anekand, e ishte nji entuzjazem aq i madh sa mzi qi pritshin me ra në luftë kundra turkut per me provue trimnm e besnikin e u dote ma ba çmos per me i ndalue qi mos t' u shtyshin nder viset e turkut, pá pasë urdhen. Kúr ndiejshin se po kthete Skanderbegu prej lufte, kahdo kalote, populli mbarë i dilte para edhe u pergzote me te: kangë, valle, gjimimi i topave, i trompetave e i kumonve, zotnoshin ajrin prej brohorije.

Nji ndimë të madhe, morale e materiale, e pat Skanderbegu edhe prej klerit katolik. Kta e ndreqen dy heresh me Dukagjinin: i ndejen perbri per me iu gjetë në çëfardo nevojet: u suellen neper dhena të krishtena per me i bashkue pare e ushtarë; mbajten nalt moralin e popullit; e prej mbarë krishtenimit t'Europës. Nder tjerë Pal Egjllorin, Anden de Meul, Gjergj Kuken, Eugjen Sumen, Gjonin de Albania, Barletin, Tivarasin e Dhimiter Frangun, historial kombtare do t'i permendin me miradije të madhe per sherbime qi i bân atdheut n' at kohë.

Me fjalë tjera, po t' i kishte mungue perkrahja e sinçertë e klerit katolik, Skanderbegu, me gjith ato cillsi të jashtzakonshme qi pat, nuk kishte muejtë me mbajtë nalt moralin e popullit, nder kohë aq kritike, as zani i tij nuk kishte ba aq bujë n' Europen mbarë.

Sa me pá ma kjartas se katoliku shqyptár i asaje kohë nuk kje vetem fetar por edhe atdhetar i vertetë, po çekim ndonji tregim. Në mbledhjen e parë të pergjithtë qi u ba në Lezhe me 2 Marc 1444, mbasi njaj zani princat e krenët shqyptarë e zgodhen Skanderbegun per “Kryetar të pergjithtë t' ushtrive aleate”, Pal Dukagjini, nji nder princa ma në shej t' asajë kohe, kshtu shprehet: “Ishte ajo nji rasë e bukur, me e diftue seicili zellin per të miren e fës e t' atdheut, tuj mbledhë mbarë nierz të zot per armë, me ia viu perball Turkut, e ashtû edhe me numer me muejtë me u matë me te.” Në luften mandej qi i tokoi Skanderbegut kundra Venedikut, posë Lekë Dukagjinit qi ishte shkaktari, e Pjeter Shpanit e Lekë Dushmanit, qi ishte rrejtë se Skanderbegu kishte pasë gisht në vrasen e Lek Xakaris, princat e krenët tjerë jo vetem u mbajten me Skanderbegun, por edhe e nxiten me i deklarue luftë asajë republike, per me ia mbushë menden kujdo se princat shqyptarë nuk bajshin ma me u shkelë vendet e tyne prej të huejve si kishte ndodhë gjashtë vjetë perpara me të ngratin Kont Shtjefnin, Zotnin e Ulqinit, të cilit i kje rrembye zotnimi i të parve. Nji shembull atdhetarijet kundrohët edhe në testamendin e Lekë Xakaris, princit të Dejës, e Koronës, princit të Beratit, qi i lanë vendet e veta Skanderbegut në trashigim.

Por, mjerisht, kjo kohë e lume per vendin t'onë nuk ngjati, pse me deken e Kreshnikut t'onë, 1468, mbas njaj mbretnimi prej 24 vjetsh, të kalueme në luftë

kundra turkut, për lirin e Shqipërisë e mprojtjen e Europës, tuj u vorruen në dhe trupit i tij, bashkë me të u shtij në dhe edhe Shqipëria e lirë.

Me deken e Skanderbegut, Shqipëria mbetë pa at pris, i cili jo vetëm i pat dhanë shpirt e fuqi bashkimit, por edhe qi diti me muejtë e me dërmue përherë ushtrinë të mdha me një numer të vogël luftarësh. Pal Egjllori, i cili mbas fjalës së mbretit të deken kishte marrë rejen e sundimit në vend të trashigimtarit enë foshnje, ishte i zoti i fjalës, i kshillit e i pendës, por jo i armës. Po të kishte pasë Shqipëria fatin me pasë një gjeneral të zotin me bashkue e me organizue vendin në ket kohë kúr Sulltan Mehmeti i II ishte i xanun me lufta në Persi, e s' i dilte me e msy dhen t'onë me një ushtri teper të madhe, patjeter se Shqipëria muejte me qindrue edhe për një kohë të gjatë si shtet i lirë. Por tuj i mungue një nieri i atill me i marrë kamen Skanderbegut, çdo shpresë për një fitim të fundshem ishte e kotë. Me gjithka Shqipëria e ligshueme prej lufte, e vorfnueme prej atij farë burri, e lanë mbas dore për Europe, muejti me perkrahje të Venedikut me qindrue kundra kolosit turk edhe për njëmdhetë vjet rresht.

Dy herë në vjetë, në kohë të korres e të vjeles, në prendverë e vjeshtë, vishin ushtri turke rregullisht përpara Krueje, Durrci, Lezhje e Shkodre, e në qandra tjera, tuj shkretnuen vendin me zjarm e hekur, për me i ngushtue ashtu me iu dorzue, por frymzimi i heroizmit të Skanderbegut ishte enë aq i gjall ndër zemra të shqyphtarve sa s' i lshuen një pllambë dhe për pa e la përpara mirë me gjak. Deri tuba vajzash shqyptare, mblihdeshin rregullisht krye tetë ditve mbi kshtjellët ku ky kishte mbretnuen, e në mjedis t' ushtimit të topave e të nierzve të vram këndoshin në valle këngë trimnijet mbi Skanderbegun, për me u dhanë fuqi të vetve me luftue e me dekë si burrat, njashtu si paten luftue e dekë të parët e tyne.

Ndër të gjitha kta të msyme na kanë mbetë të pershkrueme vetëm dy rrethimet e Shkoders (1474, 1479) e aj i Krues (1477). Në vjeten 1474 një ushtri e madhe turke nën komanden e Sulejman Pashës hini në Shqipëri edhe mbrrijti drejt në Shkoder, e e rrethoi në të gjitha anët. Po Shkodra, megjithse nuk i erdhi ndihmë prej kurrkahi, qindroi aq trimnisht, sa mbasi Sulejman Pasha bori pjesen më të madhe t' ushtrisë, u bajtë prej Shqipërie.

Shi në ket vjetë, 1474, Princ Gjon Kastrioti i III, trashigimtari i fronit të Kastriotëve, nuk dihet se për ç' arsye lanë nën mprojtje të Venedikut shtetin e vet, me konditë me i lshue kúr do ta shifte me udhë me kthye, vojti me t'amen në Trani (Itali). Kshtu një pjesë e Shqipërisë hini nën mprojtje të Venedikut, e shka ishte e pushtueshme prej Turkut u vu nën qeverim të njëj nipi, prej motre, të Skanderbegut i bamun muhamedan.

## Rreziku i Otomanizimit

Tuj iu dukë Sulltan Mehmetit të II turp e marre me zatetë para një vendit aq të vogel të Ballkanit, në sa Europa mbarë dridhej prej tmerrit ushtrisë së tij, me 1477 u nis vetë me një ushtri 150.000 vetësh edhe mbërriti afër Kruje. Fitimet e para u dukshin kahë shqyptarët, por mbas tremdhetë muejsh rrethim, mprojsat e atij gjyteti tuj mos shpresue ndimë prej kurrkahi iu dorzuen me 15 Qershuer 1478, me konditë me i lanë të lirë me dalë me armë e me plaçka. Sulltani i pranoi konditat, porse, marrë dorzimin e fortesës, bani me ther burrimin, e grat e fmit kjenë çue rob nder dhena të Turkut.

Prej kndej Sulltan Mehmeti i II, lshohet me urdi tuj djegë e tuj shkretnue vendin kundra të vetmit baluard që krishtenimit i kishte mbetë në Shqypni, kundra Shkoders. Ky gjytet ket herë ruhej vetem prej një ushtrie të vogel 1600 vetësh. Turqit me të msyme të padame u rreken me marrë muret e gjytetit, por të rrethuemt kundershutuen sulmet turke me trimni të pashoqe. Bahej një luftë që deri m' at herë s' i ishte pá shoqja: nierz të dishpruem luftojshin kundra një ushtrifje që turrej me dishprim me u rrasë në gjytet. Të msymet e bame me 22 e 27 Qershuer kjenë per të dyja lagjet mâ të mndershmet: tuj kapercye mbi trupen të shokve të dekun, mbërriten ushtrit anmike me shti në dorë një copë të murit ku ngrehen flamurin e Turkis. Romanin (Storia documentata di Venezia, vol. IV, fq. 382) dishmon se me 27 Kallnduer t' asajë vjete kishte pasë ardhë në ndimë të Krues edhe Princ Gjon Kastrioti. Në mjes të mprojsave të gjytetit të rrethuem ishin edhe dy rregulltar, Domenikani, Pater Bartolomeu e sidomos Françeskani Pater Pali, prej Matit, të cilët me fjalë të zjarrta e me tregim ndizshin zemrat e luftarve, per kundershitim. Në ket sulmim të mnershëm, Françeskani i naltpërmendun turret me aq hov kunder të parit që ishte tuj ngulë flamurin, sa ia rremen prej dore, çon "jeniferin" shul perpjete edhe e plandosë dekun në fund të murit të kështjellit. Mbas tregimit të tij mprojsat e kshtjellit ran si bisha n'anmik e u duel me la lesh me ta; kaq, sa, posë të varruemve mbeten dekun 12 000 Turq, në të rrethuem vetem 400. Per me ligshutue fatosat e Shkoders nuk i vjefi Sulltanit as ngushllimi që pat në muejin e Gushtit tuj shti në dorë Drishtin. Mprojsat e ktij gjyteti mbasi paten qindrue si burrat tuj pague mirë vedin, mbeten dekun deri ma i mbrami tuj u perla me turq. Krent e tyne u bajten në shpata e heshta rreth mureve të Shkoders per me demoralizue të rrethuemt, por nuk i lshoi zemra e vijuen në qindresë edhe do muej të mirë, e shka deri grát që si luanesha luftojshin perbri të vetve.

Te mbramja, Shkodra, ngushtue prej ujet, me 25 Kallënduer 1479, mbas një rrethimi pesëmdhetë muejsh edhe mbas një mprojtje heroike, kapitulloi me konditen që garnizoni edhe banorët të dilshin lirisht me armë edhe me plaçka të veta. E kúr çeta fatose - katerqind e pesdhetë luftarë mbetë gjallë prej 1600 vetve sa ishin kenë kúr u ndrynë per me qindrue, e 150 nder ta gra, fmi e pleq - duel prej kshtjelli, me armë, municjon e plaçka, duelen edhe dy rregulltarët, e një nder ta ba

palë, barte nën sjetull flamurin nën hije të cilit, ata që kishin mprojtë Shkodern, kishin pasë luftue me aq trimni. Sulltan Mehmetit, ket herë nuk i duel me hanger fjalën, pse komandari venecjan Antonio da Lezio kerkoi edhe mori prej atij disa vetë, si peng besnikijet. Shkodranët riskgjat, me perkrahjen e Republikës, u venduen ndër dhena të Venedikut. Rrethimet e Shkoders e të Drishit i bân me bjerrë Turkut 45000 vetë. Me t'marrmit dorzimin e Shkoders, Sulltani e plotsi mposhtimin e Shqypnis, pse edhe ato skele që mbeten edhe do kohë nën Venedik -- Durrës, Ulqin, Tivar e Vlonë -- nuk kjenë të zojat me i ba një reaksion të qindrueshem. Amirali, Ahmet Gjedik Pasha, me fis shqyptar, me një flotë e me një ushtri të fortë, kaloi prej Vlonet në Otranto me 25 të Korrikut 1480, ky gjytet iu dorzue. Autoriteti i Apulis atëherë për më i shporrë andej sa ma parë bani një kundërsulmim mbi Vlonë, Kaninë e Himarë. Veprimet ushtarake i drejtote "Constatino Musachi Carli", nipi i Skanderbegut (fratello consobrino del figlio di Scanderbecco). Fiset shqyptare të Himarës e tjera ishin grumbullue mbas tij. Në një ndeshje me ushtri turke i vuni përpara (prapoi) tuj mbytë 1600 turq e 1005 xunë rob. Edhe i biri Skanderbegut, Princ Gjon Kastrioti i III, i thirrur prej shqyptarve kishte ardhë në ket shteg prej Italisë në Shqypni, edhe me ndimen e himarjotve theu një ushtri turke që u dergue kundra tij, e shtiu në dorë një pjesë të madhe të mbretnis atnore. Kryengritja u përhap në Veri e në Jug edhe mëzi u fashit mbas disa vjetësh, edhe atëherë ky me krenë e me një popull të madh vojtë n' Itali. Mbas tregimit të Princ Gjon Kastriotit të II, edhe familje tjera të para të Shqypnis merguen ndër dhena të krishtena e me ta një numer fort i madh vogilje, sa gjytetet e katundet mbeten shqimit të shkretnueme, pse edhe ato që nuk merguen mueren malin për mos me ra në dorë të Turkut, e çdo shej gjytetnije u zhduk. Gjon Muzhaka (Hopf. fq. 276), mbasi difton hikjen e vet, thotë se "...dosi aneo quell' altri Signori d' Albania chi fuggi e chi si fé Tureo; il tutto ando in roina".

Gjëjen e mjerë të shqyptarve t' asajë kohe kshtu ia kjan Shejti At Papë, Pali i II, Filipit, Dukës së Borgonjes: "Shqyptarët disa janë mbetun në luftë dekun, disa rrethue gjithkahë prej mjerimesh. Gjytetet që parandeshin për ne një murojë kundra Turkut ran ndër durr të tyne. Popujt e aferm, që banojne bregun e Adriatikut, tuj pase parasysh rrenimin e plote, dridhen. Gjithkund frigë, gjithkund vajë, gjithkund deké e robni kemi parasysh. Æsht mjerim me ndie, se si æsht çatrafilue gjithshkahja. Nuk mund t'i shofin nieri pá derdhë lot lundrat e ketye refugjatve që msyjnë limanet e Italisë, familje të zhguluna prej votrave të veta, tuj ndejë buzës së bregut të detit, çojnë duert kah qiella, e mbushin dhën me vajë e ankime."

Qýsh me ket kohë, që u zhduk të thuesh faret aristokracija e naltë, influenza e kishës u ba shum e madhe. "Priftent e ipeshkvijt vetë atëherë ishin luftarë të rrebët, që iu pershtatshin çarkut të vet. Prej maleve të Zetës deri ne Oher e në Himarë shifen prova të shformimit të fiseve të organizueme në fuqi hjerarkore shtetnore".

Kjo influencë e klerit vijoi për gjith kohen që mbretnoi Turku ndër ne. Edhe

në kohën e mbramë të këtij regjimi për çdo punë me randsi në Malsin e Madhe u lupte për krahja e Emzot Serreqit; për Dukagjin e Imzot Shllakut, e për Mirditë e Emzot Doçit. Vetëm fjala e Emzot Shllakut bani që në vjetë 1921, t'u shpartallote aty për aty lidhja e Dukagjinit, me Serbi, e Marka Bozhit, nënprefektit të Gucis, iu desht, për me pshtue kryet, me dalë jashta kufinit, me gjithë agjentat e vet, mbrenda 24 orëve .

Po me gjithë kta mjerime shqypetarët nuk ia dan luftën turkut, sidomos Mirdita, Dukagjini e Malet e Mdhë në Gegni, e Himara në Toskni i qiten aq trazime sa të e mbramja e ngushtue Sulltani me ra në padi me ta me kto kondita:

1. liri të mbrendshme fetare e qeveritare pá kurrnji nderhymje të zyrtarve a t'ushtris turke;
2. në shej se njëfshin sypranin e Sulltanit, ka njëqind pare për tym krye vjeti,
3. në rasë lufte me të huej, do t'i dergojshin ka një sojmend për shpi, me kryetar e flamur të vet.

Kto të drejta të naltpermendura u rrejten deri ditën që u bajtë Turku prej Shqypnije.

Me kondita t' atilla shqypetarët filluen disi me u perpjekë me Turk, e tuj kenë gjytetet e katundet e pabanueme, nëpërmjet të disa krenve që kishin marrë islamizmin, u venduen kokrra kokrra familje të krishtena, me konditë mos me i trazue në fé e zakone.

N' e parë qeveria turke e sundoi vendin me qeveritarë turq, e kishin garnizone në se cilen qander. Banorët e ri të gjyteteve, me të perpjekun me ushtri, e sidomos për me pshtue prej mnis së tyne nder rasa që kishin ngatrrasa e lufta me të krishtenë, filluen aty-këtu me marrë besimin e tyne.

Perpjekjet e lidhjet e shqypetarve me turk ishin atëher sa për faqe, pse s'muejshin me e hjekë mendjet amelsin e njëj atmes së lirë. U bajshin mbledhje, u mirrshin vendime, u sajoshin plane për me i dalë doret. Lidhja shkoi tuj marrë aq të hapët sa në vjetin 1593 përshite krejt elementin kristjan të Ballkanit. Papa edhe disa Fuqi të Mdhaja të Prendimit ishin të perzieme n'at lidhje. Zjarrmi kryesuer i levizjes ishte Shqypnija e kryeqandra Lezha. Në krye të krejt levizjes ishin princat kishtarë: metropolit i Ohrit, ipeshkvi i Lezhës, patriarku i Pejës e ipeshkvi i Korculës, e Kshilli i pleqve ishte dora e djathtë (ndima ma e madhja) e tyne. Në kshillet e fiseve bashkpunojshin pranë kryetarve, edhe kleri, i nalti e i ulti (1602 due vescovi, il ministro e frati Osservanti, preti vecchi et primati di questo regno d'Albania).

Edhe për vendimet e mavonshme, shumë më të randsishme, e mueren nisjativën prelatët; ktyne ua ngarkuen edhe zbatimin.

Kulmi i këtyne lidhjeve mbrrijti në vjetin 1620. N' at vjetë (me 11të Nanduerit) u bashkuen, se do të paguejshin teloznen, në Beograd mbi Tunen, vojvodët e

Likës, të Poljicës, të Malit të Zi; mandej u bashkuen edhe krytarët e Kuçit, të Dukagjinit e të Kelmendit, qi do të vendojshin per lirimin e të gjitha viseve të pushtueme, me ndihmen e Hispanasve e të Papës.

Rrolin kryesuer, sikur palci i athershem i shqyphtarve katolikë, e luejten kelmen-dasit në fundin e të XVII qindvjet kúr ushtria austriake (1689) kishte hym thell në Ballkan. Atherë me fitimin e shqyphtarve kundra turqve, meritimet mâ të mdhajat i pat françeskani Toma Rospasari; edhe drejtuesi i kryengritsve serb kje patriarku i Pejës Arseni i III. Nën drejtimin e tij u krye levizja e madhe e serbve.

“Nuk mund të jet pra dyshim, se influenza e kishës, perveç mnis kundra turkut, kishte per qellim, qi ksenofobija edhe çashtja e pá fre e njisivet të vogla bujare, të muejte me u kapë edhe në qellime mâ të nalta. U krijuen edhe lidhje të mdhaja, të cillat të perkujtojn lidhjen gadi të njikohshme t' Irokezve (1560) n'Ameriken e Veriut, qi u kënduen prej Longfellovit në “Song of Hiawatha” në za.

## **Përçaj e Sundo**

Nepermjet lidhjeve qi u mbajten në kambë per sa shekuj, të kryesueme gadi perherë prej pjestarve të klerit katolik, shqyphtarët bane ma se njizet kryengritje të mdha në vendin t'onë, verte se u la vendi me gjak, e s' u muejtë kurr me i dalë qellimit në skaj, gjithnji vjeften per me mbajtë gjallë në popull per gjatë sa shekujve dishirin e liris kombtare. Nder të gjitha ato kryengritje ktu po permendim vetem tri të cillat paten perfundime mâ të mdha per Shqypni. E para kryengritje e madhe u ba në vjeten 1571. Shqyphtarët me shpresë se do të kishin ndimen e popujve t'Europës, porsa ndien se turqit ishin mujtun në një luftë të madhe prej austriakve, u çuen kundra tyne. Por, tuj mos pasë ndimë prej s'jashtmi u struken persri me dishprim.

Nësa vjeten mbrapa, nuk ishte shue shqimit ajo kryengritje, katolikë e muhamedan të krahinës së Shkoders, tuj mos iu ba me durue një qeveritar turk mbi veti u çuen peshë kundra ushtris turke. Ky gjytet, si edhe gjytetet tjera atëherë, mzi qi kishin fillue me marrë hije gjyteti, e Shkodra s' njehte ma se katerqind tyme, por e lidhme me male e katunde katolike, permbloodhi njizetmi luftarë, të cillt nën komanden e Brahim Beg Begollit, thyen ushtrin anmike të primun prej Pasvan Agollit. Mbas ksajë lufte të madhe iu mbush mendja Sulltanit se Shqypnija do të qeverisej me kryetarë të vendit, prandej tuj lanë një ushtri turke me komandar turk në seicillen qander, shenjoji ka një shqyphtar muhamedan me qeverisë gjytetet e krahinat e Shqypnis. Po per siguri mâ të madhe, Sulltani i la shqyphtarët të daheshin, si ishin kenë edhe ma para, në principata të vogla edhe s'prate me shtij fitme e grisa per me ngatrrue njanin me tjetrin, kshtuqi Shqypnija s' u ba tjetet veç një lamë lufte ku njani beg luftoj te me tjetrin. Kto lufta të mbrendshme i mbajten në kambë per gjith at kohë të gjatë qi zotnoi Turku në Shqypni. Disa nder kta kryetar shqyphtarë per me fitue simpatin e Turqve e të Sulltanit u bân mashë e verbët e

tyne, e ngatrruen muhamedan e kristjan, prishen e rrenuen çdo shej kulture e perparimi.

### **Konvertime Masive në Fenë Islame**

Nji kryengritje tjetër kje ajo e vjetës 1689. Mbasi Gjon Sobieski, mbreti i Polonis, i thei Turqit për rreth Vienet, ushtria e krishtenë i vuni gjithkund përpara turqit, e shkoi tuj ndjekë deri mbrenda disa viseve shqyptare. Krishtenimi i Shqypnis atëherë iu perkrash Austris, por ushtri të reja turke me Zherajin që kishte me vëdi 100.000 Tartarë ia mbrrijten në ndimë të tyne e i dbuen Austriakët prej Shqypnise. Nenshkrue traktati i paqës ndërmjet të Turkut e t' Austris (1683) në Carlovitz, Zheraji i ra kryq e terthuer me ushtri tartare Shqypnis mbarë tuj rroposë që me themel çdo shej krishtenimi. Kje ndjekë kleri, ndalue veprimet fetare e deri ku mbrrijti me u shty turri i tij kjenë shtergue të krishtent me marrë muhamedanizmin a me sharrue. Në ket rasë u zhduk gadi shqimit katolicizmi në Gash, Krasniqe, Lumë, Has, Mat, Diber, Bendë e Shpat. Gaspari (1671) difton neper kto vende [kishte vetëm] gra të krishtena. - Marin Bizzi, 32 katunde prej Lezhje e n' Elbasan të krishtena. Nder këto vende kjenë ba edhe shum muhamedan për me pshtue prej teloznes<sup>27</sup>.

### **Në anë të Austrisë, sëbashku me Serbët**

Në vjetë 1737 Austriakët në luftë me Turk msynë rishtas Shqypnin e paten në ndimë edhe Lekët e Malsis në luften e pergjakshme që u ba në Valjevë, prej 20,000 malcorve e serbve që u gjeten perbri austriakve nuk pshtuen veç 1.000 nder të cilit 500 kelmendas që nuk mujten me kthye ma në vende të veta por ngulen në tokë t'Austris ku mandej perban do katunde në veti. Levizja ishte ndezë edhe mbrenda në Shqypni, e Turku bani dy vjet për me e shue tuj perdorë mndyrat ma barbare, tuj shkatrrue vendin e tuj qitë faret nierzit.

[Çerkezi shkruan], “Këto kryengritje, e veçan të dyja të fundit (1689, 1737), patne një perfundim fort të math për Shqipërinë. Pasi u mbytnë kryengritjet, Turqit nisne të mundonin rendë ata që ishin berë shkak e ata që kishin marrë pjesë në këto kryengritje, dhe ata të mjeret s' panë nonje udhë tjetër për të zbutur zemren gjakpirëse të turqve veçse duke perqafuar fenë myslimane ... Me këtë mënyrë nisi të perhapet feja muhamedane në Shqipëri ner lufterat e kryengritjeve kundra Turqve. Për fat të keq kjo ngjarje u bë shkak për një ndarje për fitim të Turqisë e për të perdorë ca me teper shqiptarët.”

Po është për t' u vu oroe se, me gjith dhëlpnit, fitmet e grisat që shtini Sulltani nepermjet agjentave të vet, për me mbajtë lerg njanin element me tjetrin, idea e

---

<sup>27</sup> Muhamedanizma në Shqipëri u perhap më parë nepër krerët, ca prej të cilëve u kthejn nga interesë dhe pa shtrengicë që nga koha a Balsheve, dhe të tjerë nga e keqja pas vdekjes së Skaenderbeut. Në popull u perhap dalë nga dalë në shekujt e pastajmë. Çermenika u kthye në kohën e kryengritjes frenge me 1793, dhe pjesa m'e madhe e Labris në kohën e Ali Pashës, në krye të shekullit të nentembdhjetë... (Fan Noli, Historia e Skenderbeut, fq. 276).

dashtnija e kombit i bani shqyptarët me luftue sëbashku pá ndryshim feje, kundra turqve, Slavëve e Grekve.

Kta sëbashkut me Brahim Beg Begollin në vjetë 1572 e ngushtuen sulltanin me ndrrue mendim e me e qeverisë Shqypnín me qeveritarë. E kúr pjestarët e ksajë familje u bân masha e Sulltanit i rrxuen e perkrahen Bushatlit, të cillve iu gjeten ndihmë kundra Turkut e Malit të Zi.

\*\*\*

## Kongresi i Berlinit

Nji kontribut atdhetarijet çfaqen katolikt shqyptarë edhe në kohën e Kongresit të Berlinit, e të tanë pá perjashtim perkrahen “Lidhjen e Prezrendit”. Porsa u muer vesht se posë krahinës së Tivarit qi mâ ishte në dorë te Malit të Zi, Kongresi kishte vendue me iu lshue krahina e Plavës e Gucis, Lekët e Malcis jo veç u lidhen me banorët e atyne krahinave, por me pushkë në dorë i bân gardh natë e ditë kufit e jo veç nuk e lanë me u pershkue neper ta, por me anen e Dukagjinit shkuen e u bashkuen me ta per me iu gjetë ndimë, kshtuqi para gjith atij mori luftari Mali i Zi ngurroi e në vend të tyne lypi e u shnderruen me krahinen e Podgoricës e Ulqinit.

Po edhe në ndihmë t' atyne krahinave rrani Shkodra, Malcia e Madhe, Dukagjini e Mirdita, nën kryepari të Preng Bibë Dodës, Princit të Mirditës e të Hodo Begut. Me gjith at mori katoliksh ishin edhe tre meshtarë: D. Ndue Shllaku, prift Shkodre, e P. Gjon Grumeli e P. Luigj da Coriano françeskaj.

Ankimet e Malit të Zi para perfaqsesve të fuqive të mdha ia mbushen menden se ishte nji lidhni e mshefët ndermjet shqyptarvet e Turkis, e Lord Grandville, Ministri i Inglis, bani qi me 22 të Qeshorit 1877, t' i epej ultimatum Turkis, qi t' iu dorzoshin mbrenda tri javëve malazezve visja e bregut të detit prej Tivarit e deri në Grykë të Buenës.

Per me e forcue ket vendim fuqít e mdha banë nji demonstratë morale në limâ t' Ulqinit, e shqyptarët të msym prej malazezve e prej 30.000 turqve të primun prej Dervish Pashës mbas sa ndeshjesh, në vjetë 1880, tuj mos pasë kurrfarë ndime prej Lidhjes së Prezrendit, u shpemandan nder vende të veta, e Dervish Pasha hini n' Ulqin e i a dorzoi Malit të Zi. Kshtu malazezt u shtrin prej Tivarit e deri në Grykë të Buenës e andej per buzë të liqenit të Shasit, neper Krajë, në Podgoricë, Zhabjak, Fundinë e Triepshë. Në caktim të mbrame të kufive me Mal të Zi, perfaqsuest e Fuqive të mdha e kishin lanë vjerrtas krahin qi prej liqenit kalon kah Podgorica e Mali i Zi lypi e iu pranue me u shty deri në Prrue të That qi çan per mjedis Malsin e Madhe. Kjo punë ndezi nji kundersizim të ri e në vjetë 1883, Malet e Mdha, Hoti, Gruda, Kelmendi, Kastrati e Shkreli u betuen me u shkri me rob e robi para se me i lshue tokët e veta në dorë të Malit të Zi.

Rrypina e lypun prej Malit të Zi nuk kishte nji randsi sa me çue peshë Europen,

prandej Mali i Zi, tuj mos ia pá gjasen me e shtrure me fuqi, s' i dha punës pertej e kufini kje caktue në breg të Cemit.

Mbasi mbaroi çashtja e kufinit, Sulltani megjithse vetë n' e parë i kishte nxitë me trajtue Lidhjen e Prezrendit, me shpresë me perfitue në shpinë të shqyptarve, tuj e pá se me at lidhje ishin ngjallë ndisit kombtare e dishiri i emancipacionit ishte perpajnuë nder zemra të shum shqyptarve, xuni e interoi Preng Pashen e të gjith kryetart e asajë lidhje. Per me da mandej elementat njanin me tjetrin dergoi me qeverisë Shqypnín qeveritarët ma fanatikët, çili një numer të pamatun meitepesh, dha leje me u çilë shkolla me propagandë e gjuhë të hueja e shqypja jo vetem u perjashtue, por i kje mohue tagri. Njaj propagande aq të damshme per kombin t'onë u munduen me i ba reaksjon sidomos kolonit shqyptare të Rumanis, të Bullgaris, t' Amerikës e t' Italis me shkrime e propagandë, e mbrenda Shqypnijet kleri katolik mbrijti me shti neper shkolla të veta edhe gjuhen shqype.

Kemi pershkrue deri ktu ma fort se tjetet atdhetarin qi çfaqi katoliku shqyptar neper fuqin e armve, po tashti po pershkruejm, sa ma per së shkurti, vepren e tij të zhvillueme nepermjet të shkrimit, me të cilen bani me u njoftë historija e gjuha e jonë nder popuj të gjytetnuem. Verte në ket degë nuk mund të pritet shum prej tij pse per sa shekuj nën zgjedhë të një populli qi: - T'ardhurë prej Azisë (Turqit), mbetën të huaj në Europë, në vendin e Qafiravet, në ket Dar-ylqyfr, Day-ylqyfr, Dar-yl-Harb, me pushkë në dorë, kordha çveshurë, mbi shalën e kalit. Nuk muarën asnjë gjë prej gjytetërimit të rilindjesë, s' kuptuanë asnjë gjë nga nevojat e ra të jetesësë. Mbetnë vetem, të izoluarë, të huaj me fqinjët dhe me raja-të lumturë nga injoranca e thellë e tyre, injorancë që e pshehënim me kënaqesinë që u epte arroganca e tyre dhe një kujtim i mjegulluarë i pushtetës dhe i madhërisë së shkuarë.<sup>28</sup>

E pra edhe me një dominacion aq të mnishem katolikun shqyptar nuk e lshoi zemra, po në mënyrë të vijueshme punoi për historin e gjuhen e vet.

Tivarasi, Barleti, Dimiter Frangu e Anonimët na trashiguen historin e kohve të lume të kombit t'onë –

Buzuku, Bardhi, Bogdani, Vinçenc Zmajeviqi e Jul Variboba na trashiguen gjuhen shqype të kohës së vet.

Mbas gjurmës së tyre një numer i madh katoliksh botuen vepra në gjuhen t'onë, qi per shka dijm deri më sod mund të rendohen kshtu:

Prej vjetës 1555 deri në vjetë 1700 njofrm 16 vepra e 14 autorë nder të cilët është Buzuku, Matranga, Bardhi, Budi, Bogdani, Tivarasi, Barleti, Dimiter Frangu, Anonimët, Gjon Muzaka etj.

<sup>28</sup> Lum Skendo (Mit'hat Frashëri), Hylli i Dritës, v. V. n. 9. fq 351

Prej vjetës 1700 deri në vjetë 1800 kemi 15 vepra, 13 autorë e 6 dorshkrime, nder kta P. Françesk da Lecce O. F. M., Zmajeviq (Kuvendi i Arbnit) , D. Gjon Kazazi, Jul Variboba etj.

Prej vjetës 1900 deri në kohen e turqve të Ri gjejm 40 vepra, 10 autorë. Dohen në shej: P. Gjergj Fishta, D. Ndoc Nikaj, D. Ndre Mjeda, P. Anton Xanoni S. J., P. Shtjefen Gjeçov O. F. M.

Do shenjue, se Emzot Preng Doçi, Abat i Mirditës, tuj i ba ball vshtirsive qi asokohe ndeshte, prej anet të Qeveris së Stambollës, në vjetë 1899, themeloi një shoqni letrare, mbrenda Shqypnije me emen “Bashkimi”; e pak mbrapa, Don Ndre Mjeda, një tjetër me emen, “Agimi”. Kto dy shoqni posë qi bân me u botue tekstet per shkolla fillore, botuen edhe shum libra per dobi të popullit.

Një send qi bjen në sy është se veprat e tyre janë pergjithsisht me landë fetare, po kta ndodhi per dy arsye; së parit pse ashtu muejshin me pasë perkrahjen per botim prej Selis Shejte, së dytit pse veprat e tyre ishin të kufizueme me kenë të lexueme vetem pri meshtarve e një numer të vogel katoliksh qi u kujdesojshin me xanë e me lexue gjuhen e vet, mbasi shkollat nuk ishin as nder gjytete. Se qellimi i tyre nuk ishte vetem fetar por edhe patriotik na e dishmojnë edhe ata vetë disa heresh nder shkrime të veta.

Bogdani, në vepren “Cuneus prophetarum etc. (në parathanje)” shkruen nder tjera ... *“E madhe do bij e frujt anshtë pra, me ndrequn ket shkallë t’ urtjës e me të shkruem bukur me shqyretuem e me dijtun se si duhet nierit të temelitun me u percjellë sa anshtë mbë ketë jetë me frujtit e shpirtit të vet ende të popullit, të mos lanë dijen e gjuhen e dheut me u dvarun; pors i lefton gjithë dheu e shekulli per të veten ... Të lutemi pra, letrari i em i urtë, të më ndiejsh, ndë gjeç fjalë, qi të trazon veshët. Perse as djelli pá hie, as hana pá tallazë mbë faqe nuk anshtë; po ven roe se kush na ka pushtue e ndë kuejt dhë jemi, ani me zemer anko, posi tha Ovidi”* (Lib. 3, Elegia 1.): Si qua videbuntur casu non dicta latine, in qua scribebam, barbara terra fuit.

Në vjetë 1703, Papa shqyptár, Klementi i XI, urdhnoi me u ba në Shqypni një konçil provincjar. Aktet e ktij konçili lypi t’iu paraqitshin shqyp e latinisht, të cillat bani me i’shtypë në vjetë 1705. Në letren percjellse, Emzot Zmajeviqi thote edhe: “ ... Nden hie tande, o i Lumnueshmi At, po gëzon dheu i arbëneshë; e mbas të sjellitit e motit ngrihet, po si disa mot të kishte kjenë mbulueme ndë njegull, tashti nden Papë Arbëneshë,- qi latinisht do me thanë të bardhë [mbienëni Albani - i bardhë] , - është dalë më dritë; e me zemer të mirë shkathon me mërr mbë lumeni të shkueme. Ndierse mendja e Atit, e cilia është ma e madhe, se rrethi i shekullit buron me të dashunit të Tinëzot ketë lumëni të dheut s' inë.

Don Jul Valiboba në poemin “Gjella e S. Mëris Virgjer” shkruen në parathanje: “Qi ti, qe gjavasen (lexon) mos xe fill nanë të qeshnjesh e të gjellinjesh dhunë (të vijë marre), njota se edhe gjuha arbreshë do të hinje nder qiell e të xer fill edhe ajo

kangjli' e sajë (kangen e vet) ... Vure kree se kto ehoa kan t' i pelqenje, në mos arbreshvet, mos t'jater Shenë Mëris. Pse është nje kenkë në nje gjuhë, qe po sa di un, nuk ka nxjerrë ndonjo eho shejtë ... “

Në kohë mâ të kndejshme, 1870, Emzot Preng Doçi i shkruete shkrimtares shqyptare në za, Dorës d'Istrjes, per me e nxzite me punue per të miren e atdheut:

Dheu i em! me trima plot një herë, si pyll,  
E vetme tash, ço ballin t'and, mos k'aj  
Shkelzen ne e mbram mbi ty një i dritshim hyll,  
E djelmve t'u kallxon gjithëkëto travajë.  
Per gëzimin t'and gjith malet kanë lulzue  
Kerset kadal, kadal per ty një prrue.

.....

Kjo s'â, jo s' âsht këjo mendja e Dorës s'onë!  
Çoi zan Helena, por kafolë tu msha,  
Kafolë në vajtim, e zani u da. Fort vonë  
Do të ndalet aj: Gjith token ka perla.  
Ai za s'â vajë! Bumbullon gjithkahë si rrfe.  
Bumbullon. Ah! Në Qiellë luftohet prap per ne?  
Ah! Dorë, mba zâ'n e kthe në gushllim, n' uzdajë,  
Vajtimin tand, pse ti per këta ke le.  
Mendo se vllazent t' tu janë bamun rajë!  
Janë shkelë gjithëkund, gjithëkund vu  
në shej e pre!  
Na jemi hupë! Prej së naltës qiellë harrue!  
Nder sy të gjithëve: popull i mallkue!  
Ip doren, ip Shqipnis, e nalta Dorë!  
Do të çohet prap prej baltet, do të lulzujë.  
Ip doren, Dorë, gjindes sate. Një kunorë  
Po të falim na, po të njohim të gjithë per Zojë.  
Mennerin të dhenun: mbi një kâjkë mâ të ranë  
Ka nisë per nipat namin tand një Zânë.”

Prej entuzjazmit qi ndie te Don Ndue Bytyçi per larimin e gjuhës amtare i çote në vjetë 1874 P. Leonard De Martinit ket tingllim:

Çëfarë zani â kyne, qi në Troshan tuj nisun  
 U hap në Shkoder, në Prezrend, e mrrini  
 Deri në Pejë t' eger, e në zemer më hini  
 Me mekam t' amel të fjalve në kangë ujdusun?  
 Kush muejti giuhen në harresë të braktisun  
 Në rybe me e rritë kaq fort? e kush e mshini  
 Marren prej neve, qi der sot na ngini,  
 E na pat lanun në terrinë të braktisun?  
 Ti, o Leonardo; zani i yt po ndihet  
 Porsi bylbyli, qi kendon në prendverë  
 Kúr soset dimni, e aklli e bora shkrihet.  
 Zanin pra, çoje qi e ke nisë kaq marë,  
 Byblyl i ri, ty kanë Shqyptarët me të nderë  
 Nder bejtaxhit bejtaxhi ma i parë!”

Nder mâ të mbramët per kohë, por mâ të gjallët per ndiesi kombtare njifen P. Gjergj Fishta, Don Ndre Mjedja, P. Vinçenc Prennushi e P. Shtjefen Gjeçovi, të cilët me vepra të veta i dhanë një shkas të madh lavrimit të gjuhës shqype, e trajtuen një numer të madh të pionerve t' independecës kombtare.

vazh. Prandaj Shqypnija, në kje sod e palavarshme, do t' i a dijë fort veprimet të klerit katolik, qi sidomos neper studim të gjuhës, e vuni n'udhë të perparimit një popull, qi per sa e sa shekuj i ndej lerg çdo veprimet të perjashtem.

Ket meritim të klerit katolik pergjithsisht edhe kombi mbarë jau njef. Fletorja “Shqiperija e Re” me 19 Kallnduer të ktij vjeti thote botnisht e tekstualisht njikto fjalë: „. “Kurse tjetër klerikë të Shqiperis mallkonin shqipen dhe Shqiperin, Kleri Françaskan derdhte gjak, dirsë edhe inteligjencë per të zhvilluar gjuhen dhe ndjenjat kombetare”.

Prej shka âsht vu oroe deri ktu rezulton se feja katolike i dha Shqypnis mprojsat mâ të mirët, kreshnikët mâ të mdhejt, inteligentat ma në shej, e mâ të mdhejt e mâ të shumët kultora të gjuhës kombtare. Pervec ksajë, në malet katolike të Shqypms së verit, u ruejten mâ të pastra doket e ligjtë qi, gojdhane mbas gojdhane, u kapen deri nder kohë t'ona. Nder ta u ruejtë edhe ma e spikatun gjurma karakteristike shqyptare; ma e gjallë ndisija kombtare, e prej andej duelen një numer i mirë pionersh per independencen shqyptare.

## Turqit e Ri

Mbas Kongresit të Berlinit, në sa Shtetet e Ballkanit nisen me u mkambë e me perparue, Turkut iu dha aq teposhtja sa te e mbramja Fuqit e Mdha te Europës ran në mendim se si me e coptue fare. Tuj iu kujtue ktij rrezikut edhe turqt vetë u çuen e themeluen një Komitet qi e quejten “Bashkim e Perparim”, e vedit ia ngjiten “Turq të Ri” e me 10 Korrik 1908 ngushtuen Sulltan Abdyl Hamidin me dhanë Kostituten. Me ket hap besuen pjestarët e atij Komiteti se e pshtuen atmen e vet, e se Shtetet e Europës nuk do të kishin ma shkak me iu perzi nder çakla, mbasi aty e mbrapa edhe mbretnja e tyne do të qeverisej me sistemin europjan.

Komet qi per sa qindra vjetësh kishin vujtë nën robni turke u gzuen per së forti tuj mendue se po fillonte edhe per ta një jetë e re, e shqyptarët, posë tjerve, ke s' kishin kurrnji shtet të madh mprojs, prej friget mos të bishin në një robni mâ të dhunshme, iu perkrahen atij Komiteti me mish e me shpirt. Ky persuazjon permirsimi u depertue aq në zerner të gjithkujë sa deri malsorët u vullnuen me dorzue armët, shka me fuqi nuk kishte mujtë me e ba turku as atëherë kúr mbarë Europa dridhej prej frigës së tij.

Por s'vonoi e u kujtuen shqyptarët se ishin pshtetë në një drrasë të kalbët: e pan çiltas se regjimi i ri ishte per ta ma i rrezikshem se aj i perparshmi. Turqt e Ri porsa mueren në dorë rejen e qeveris harruen rrezikun qi u gercnohej e nisen me marrë neperkamë komet e ndryshme të mbretnis: i penguen në çdo nisjativë kombtare, shtijn fitme ndermjet muhamedanve e kristjanve, çarmatisen dhén, e lypen sherbimin ushtarak e pagesa edhe nder vende ku parandej ishin kenë të lira. Me gjith lirin e çpallun prej tyne lypen muej e muej per me xjerrë lejen e botimit të njaj gazetës shqype në Shkoder, e vetem në Kallnduer 1910 muejti Dom Ndue Nikaj me mkamë një shtypshkroje të lirë e me botue një gazetë shqype me emen “Bashkimi”.

## Lekët: Kryengritjet 1911 - 1912

Barbarsit [otomanët], mandej, të kryeme prej Gjavid Pashës e Shefqet Turgut Pashës per me shtypë shqyptarët çuen peshë zemrat e shumkujë, e Lekët e Malsis qi nuk ishin kenë msue me u ba raja e kuejë, tuj e provue se vetem arma muejte me u sigurue gjan, mallin, nderen e të drejtat qi kishin pasë gzue per qindra vjetësh edhe nën Turki nisen me u lvisë. Qýsh në prendveren e vjetës 1910 shifen faqe sheje paknaqsije: t' arratisunt shtohen e në krye të çetave kryengrttse âsht “Kreshniku i Malsis”, Dedë Gjo' Luli. Ky e Kolë Toma, Bajraktari i Velës, ishin të vetmit në krahinen e Shkoders qi tuj mos zanë besë njaj permirsimi me djelm të vet e kushriní nuk kishin dorzue armët e ishin arratisë.

Kaloi gjith ajo vjetë pá ndonji ngjarje me randsi, por me 24 Marc 1911 zuni fill një luftë e vertetë kundra Turkut. Populli mbarë i Malsis i lidhun me kryengritës, me pushkë e pá pushkë msyni njisherit të gjitha postat qi gjindeshin mbrenda

kufinit të Malcis Madhe, e me at turr n' e nesre, pushtuen edhe Tuzin, e ashtu të foreuem me armë e me municjon u drejtuen kahë Shkodra e u qandrruen në Koplik. Mali i Zi, i cilli mzi qi pritete me pá pshtjellime në Turki, tuj e pá se Malcorët ia kishin nisë punës pemjimend, u vu me i mprojtë e u la kufinin lirë me hi e me dalë.

Lajmi se Malcia e Madhe ishte çue peshë e dojte me msy Shkodern e qiti në mendim Bedri Pashen, valin e atij gjyteti, e me shkak se ishte Dini në rrezik rrejt muhamedanët e vendit, e kush kje i zoti i armve u bashkue me asqer e duel në luftë kundra malcorve.

Kta [Malcoret] per me i diftue Fuqive t'Europës e shqyptarve qellimin e kryengritjes bân me 30 Marc nji Mbledhje në Cetinë e i çuen nji “memorandum,” Fuqive të Mdha e Malit të Zi. Në ket Mbledhje posë krenve të Malsis mueren pjesë e u lidhen me ta edhe disa kren me randsi të vendeve tjera, të krishtenë e muhamedanë.

Me ket “memorandum” kta lypshin:

- 1) Token shqyptare të paprekun;
- 2) Gjuhen shqype per gjuhë zyrtare nder kater vilajete e porsu gjuhë msimit nder shkolla, nder zyre, nder gjygie etj.
- 3) Të gjith sunduesët e Shqypnis t' ishin shqyptarë me komsi, e qi kjo komsi të njifej zyrtarisht prej Qeveris së Stamollës;
- 4) Të himet e prodhimit të Shqypnis të shpenzoheshin per dobi të ktij komi;
- 5) Ushtarët qi mirreshin prej Shqypnije mos të kalojshin kufinin e Shqypnis, per posë të ndonji luftës me Qeveri të hueja.

Ky “memorandum” kje i nenshkruem pose prej *dy kryetarve të kryengritasve, Dedë Gjo' Lulit e Sokol Bacit*, edhe prej

*Mubarrem Beg Bushatit* (n' emen të Shkoders), *Isa Beg Boletinit e Abdull Agës* (n'emen të Kosovës), *Kapidan Preng Marka Kokës* (n'emen të Mirditës) e *Mehmet Shpendit* (ne' emen të Dukagjinit).

Nji lidhje e atill, dy elementash, dukej n' e parë se do të prodhojte nji dobi të perbashkët, por muhamedanët e Shkoders vijuen me u mbajtë me qeveri turke, e kta me asqer u nalen sulmin malsorvet derisa u erdh në ndimë Shefqet Turgut Pasha me shtatëdhjetë bataljona.

Lufta e Malcis me gjith at mori ushtriye vijoi per do muej të mirë, por te e mbramja ushtriya u rras në male e në vrru tuj djegë e tuj ba fani vendit. Me gjithkta Lekët e Malcis nuk i la zemra, e sigurie shumica, robt e gjâ mbrenda kufinit të Malit të Zi, bân luftime të thuesh dita me ditë, e aq të rrebta, sa me çuditë boten mbarë. Fletoret europjane t' asajë kohe i pershkruajn trimnit e tyne porsu ata të herojve legjendarë të kohve të hershme. Bashkë me malcorë ishin edhe të gjith

famullitarët e tyne qi i kshillojshin e mbajshin nalt moralin, me shpresë me fitue prej asajë lufte të drejtat jo vetem per ato male, por per Shqypnín mbarë. Per ket çashtje u ipte fuqi e i nxitte edhe Ordinari i tyne, Emzot Serreqi, e shum zotni shkodranë katolikë.

Nji nder të msymet mâ të disprueme kje ajo e Deçiçit. Dedë Gjo' Luli me nji çetë të zgjedhun malcorësh me 6 Prill bani nji sulm kundra atij malit të forcuem prej turkut. Me nji trimni të pashoqe malcorët u rrasen mbrendë, e kapën fytafyt me asqer, s' lanë gjallë nji per be, e vunë në vend flamurin kuq e zi.

Per nji kohë të mirë Lekët kjenë të vetem tue i ba ball ushtris turke, por kahë mjedisi i majit u erdhen në ndihmë njimi vetë prej Shalet e Shoshit e tetëqind të Nikaj e Mertur. Edhe bajrakët e Pukës e Mirdita u çuen fjalë se ishin të njaj mendimit me ta, por nuk ia shifshin gjasen per nji herë me ia nisë luften turkut. Kshtu mbarë katolikët e krahinës së Shkoders ishin tok njaj mendje e zemre me luftue per të drejta kombtare.

Tuj i pá Shefqet Turgut Pasha se po shkojte puna gjatë, me 28 Qershuer çoi nji komisjon në Podgoricë me u ndreqë me malsorë. Nder perfaqgues të Maleve ishin edhe Luigj Gurakuqi e Sokol Baci. Porsa u permenden amnisti e konçesjone prej perfaqguesve të Turkis, Dedë Gjo Luli n' emen të Malcorve u pergjegj se as nuk do tu xishin në gojë fjalë te atilla. "Turku, thojte aj, kundra çdo tagrit nderkombtar kishte hi e shkretue vende qi s' ishin të tijat. Malet tona qýsh me Kongresin e Berlinit edhe prej Turkut i kjenë lshue Malit të Zi. Na me armë në dorë kemi ruejtë lirin t'onë jetike perballe Malit të Zi e të Turkis e nuk jemi ba kurr të tyne. Sa pse na, si popull i vogel, jemi kenë ngushtue me ndejë në lidhje miqsore me Turk kundra anmiqve të perbashkët, e kemi ba vetem kúr na ka interesue, por kurr me zor't. Jemi kenë perherë të lirë e autonoma nder kto male, prandej kurdo qeverija turke ka me dashtë me shtrua kuvend me ne, s'do të permendin amnisti e konçesjone, por autonomi, e ket jo vetem per ne, se na e kemi pasë edhe mandej, por per mbarë Shqypnín."

Fjalët e theksueme prej kryetarit të kryengritsve u vran veshin perfaqguesve të Turkis, e tuj e dijtun se qeverija e tyne nuk ishte kurrkund gati me dhanë nji autonomi aq të hapët, u dan pá muejtë me perfundue kurrnja.

Fuqit e Mdha prej frigës mos të ngatroheshin Mali i Zi e Turkija, e urdhnuen Malin e Zi me qitë jashta kufinit të gjith kryengritsit. Lufta me gjithshka vijoj poené edhe me ma furi deri nder ditët e para të gushtit, por atëherë, tuj e pá malcorët se ishte e kotë per nji herë me folë per Shqypnín mbarë, mbasi nuk luejte kush per së gjalli, ran në godi me Turki me kto kondita:

- 1) Me dhanë amnisti të pergjithtë;
- 2) Me u lanë armët;
- 3) Mos me iu perzie në kanun, fé e zakone;

- 4) Me u çilë shkolla shqype në seicillin bajrak;
- 5) Me u pague damet e luftës;
- 6) Me u dhanë bereqeti i njaj vjeti.

Ky kje perfundimi i njaj luftës së pergjakshme të sa muejve. Verte malsorët nuk muejten me ia dalë qellimit në skaj, por mbrrijten me ia mbushë menden Turkis se me shqyptarë nuk u luete, e formuen opinjonin publik n' Europë se edhe shqyptarët meritojshin lirin kombtare si popujt tjerë të Ballkanit.

Pajtimi i Malsis me Turki kje sa per faqe, pse edhe malsorët kishin mbrrijtë me kuptue se pshtimi i vertetë do t'ishte vetem atëhere kúr t' u trajtote nji Shqypni e lirë. Pritshin prandej rasen me pertri të pergjithtë. Me 22 Qershuer 1912 malcorët e Bregut të Matës kjenë lajmue se shi m'at ditë do të kalojte andej Kajmekani i Lezhes me 500 asqer, e mbasi pritshin rasen me u kacafytë me ushtri turke, u mueren vesht me shoqishoqin e dan me ia nisë pushken të dalë si të dalë. U ba nji luftë pak orësh, por e pergjakshme. Kajmekani mbet dekun me 187 asqer, prej malscove mbeten dekun e varrue 19 vetë. N' at luftë u dan në shej Gjeto Coku me të vllan, Deden, Pjeter Sokoli i Llesh Nikë Dakës i quejtun prej disa “Leonida i Bregut të Matës”. Plaçka qi mueren n' at ditë permbahej në katerdhetë kual e mushq të ngarkuem me fishekë, mitroloza e nozull ushtriye. Me ket hap të bâm kundra qeveris turke, malcorët u bajten me rob e robi e gjâ e u rrasen mbrenda kufinit të dymdhetë bajrakve të Mirditës. Ky guxim i diftuem prej malsorve u muer me simpati prej shumkuj e menjisherë u bashkuen te Kuvendi françeskan i Rrobigut krent e Kurbinit e disa persona me randsi të krahinës së Krues e të Tiranës, Avdi Beg Toptani e Gjin Pjetri i Skurajve, posë tjerve, dhanë shpresë të madhe per nji bashkim të vertetë ndermjet të dy elementave, kristjan e muhamedan. Prodhimi i ksajë lidhje kje e çuemja e Avdi Toptanit e të Kapidan Marka Gjonit në Kongres të Shkupit, dhe msymja e Lekve me ngrehë flamurin kombtar në Durrëc, por të dyja të daluna pá dobi. E para pse në Shkup delegetent t'onë nuk gjeten ambjentin e gatuem per me lypë nji autonomi e ma pak nji pamvarsi; dhe e dyta mbaroj tuj ba fli disa atdhetarë në Rushkull, shi në fund t'Erzenit. Kta kjenë Kolec Marku, Gjokë Doda, Zef Harapi e gjashtë vetë të tjerë; Dedë Coku kje varrue let, e Llesh Nikë Daka, hini në vorr me 29 Gusht, prej tri varrve qi pat marrë at ditë. Por edhe kundershtarët e paguen shtrejt tradhtin pse mbeten tetë të dekun e kater të varruem. Kjo vllavrasje, shi në nji tokë ku ishte nisë nji bashkim elementash, e ma fort pse u xu e shkaktueme prej ndonjanit nder Toptaj, si edhe perfundimi i paknaqshem i Kongresit të Shkupit, ringjalli mendimin e kundershtimit qi vjeten perpara kishin pasë prej muhamedanve shkodranë, e fashiti çdo entuzjazëm per kahë levizjet kombtare. Nder tjerë Emzot Serreqi e Emzot Doçi u munduen me e fashitë at pabesim ndermjet të dy elementave, por ishin fakte teper të freskta e nuk u duel me qetsue zemrat e pezmatueme, prandej paten formulue nji “memorandum” fort me randsi por delegetent e krahinës së Shkoders

nuk e pan me udhë as m'e paraqitë n' at Kongres, mbasi nuk e gjeten ambjentin në favor t' autonomis.

Kshtu tuj u gjetun Shqyphtarët të dam mbeten ndermjet dy zermoreve pá dijtë kahë me ia mbajtë. Disa u vun me perkrahë Turkin, disa Ballkanasit, e tjerë u struken. Ushtria turke e pagatueme per një luftë t' atille u dermue gjithkahë, e Ballkanasit, ta pershkuen vendin tuj ba mizori të çuditshme. Kto ngjarje ia mbushen menden shqyptarve se, a atëherë a kurr, do të bashkoheshin e do të lypshin pamvarsin kombtare. Atdhetarët mbrenda e j ashta Shqypnijet çemos kurr perdoren te gjitha mjetet per pshtimin e Atdheut prej një rrezikut aq të madh. Gjithkah mbledhje, gjithkahë marrveshje, e shum herë me krye në gershanë. Nji meritim të madh pá dyshim, si ndërmjetës mbledhjesh, perpjekjesh e marrveshtjesh, si atëherë, si edhe do vjet mbrapa, e pat P. Pal Dodaj.

Para ktij rreziku të madh kombtar, Esad Toptani kje kshillue disa heresh prej disave të klerit katolik, e ikje premtime ndima e të gjith katolikve të vilajetit të Shkoders, mjaft të ngrehte në kthtjellin “Rozafat” flamurin e Shqypnis, por ky s'i vuni vesh kshillit të tyne, e ashtu s'u ba kurgja. Në ket nderkohë Ismail Qemali i Vlonës, i siguruem prej Austrije e prej Italijs se do ta mprojshin, me një tubë atdhetarë duel në Vlonë e me 28 Nëntuer proklamoi indipendencen shqyptare. Vepra e tij u prit me entuzjazem prej të gjith atdhetarve, e perbri tij, edhe katolikët, megjithse Shkodra, qandra morale e intelektuale e tyne, ishte e rrethueme, paten, nder tjerë, dy ftyra të shkelqyeshme: Emzot Nikollë Kaçorrin, qi kje i pari nenkryetar i shteti të ri shqyptar, e Luigj Gurakuqin, qi kje dora e djathtë e Ismail Qemalit.

Nuk ishte marrë vesht enë mirë çpallja e indipendencës, e me 2 Dhetuer bahet një mbledhje e madhe te Kuvendi Françeskan i Rrobigut. Aty mueren pjesë posë krenve të dymdhetë bajrakve edhe Gjini Pjetri i Skurajve e Emzot Koleci e disa pari të Zadrimës. Emzot Doçi, qi kryesojte at mbledhje, paraqiti projektin, qi kje pelqye prej të gjithve, me mkambë një qeveri të perkohshme nën kryesi të Prengë Pashës, e cilla do të permblihdhte gjith njat vend, qi shtrihet që prej Urës së Drojës e deri në Liqe të Plavës. Kshtu do të kshilloheshin me ba edhe të gjitha krahinat tjera të Shqypnis tuj caktue një qeveri të perkohshme per me trajtue të gjitha sbashkut një lidhje të pergjithtë.

Nevoja e bashkimit kombtar ndoshta ma fort se ngjeti u ndiete në Shkodem e rrethueme. Edhe aty mbrendë kishin fillue perpjekje e marrveshje, e Hasan Riza Pasha, kryekomandanti i ushtris turke, tuj e pá se Shkodra nuk do të mbette ma e Turkis, mbas kshillit të mikut të vet, P. Gjergj Fishtës, dau me e pshtue at gjytet prej Malit të Zi, tuj ngrehë në kshtjell flamurin e Shqypnis. Por në sa ishin tuj u ba lidhje e marrveshtje me Malsi me i ra gjith njisherit anmikut, Esat Toptani shûni e mbyti at kryekomandant, e marrë aj krye sundimin, me 23 Prill ia dorzoi gjytetin Malit të Zi.

Mendimi i sajuem qësh me Hasan Rizan me i ra Malit të Zi e me pshtue Shkodren kishin marrë dhen: kushtrimi kishte dalë prej Oroshit të Mirditës e kryetar i lidhjes qi do të bahej në Lezhe ishte vetë Abati i Mirditës, Emzot Doçi. Ket mbledhje të prekun per sa kohë nuk e ndaloj as të ramt e Shkoders në dorë të Malit të Zi, e ndër ditët e para të majit u mbloodh kuvendi në Lezhe ku mueren pjesë Mirdita, Mati, Gjakova, Puka, Shala e Shoshi, Malcija e Madhe, Kthella, Kurbini, Bregu i Matës, Zadrime e tjera, qi u lidhen besabesë me msy Malin e Zi e me e qitë prej Shkodert. Por per me e realizue ket të msym nuk u duel kohë, pse pá organizue planin e luftës Mali i Zi u bajtë, e me 14 Maj mueren dorzimin e atij gjyteti Ushtrit Nderkombtare. Kshtu Shqypnija u gjet e dame trish, pse posë Ismail Qemalit në Vlonë, me 13 të Korrikut edhe Esad Toptani kishte ngrhë një qeveri në vedi në Durrëc. Fuqit e Medha atëherë mbasi kishin pasë vendue qësh në muejin e Dhedorit, 1912, në Konferencen e Londers, me e njoftë mbretni në vedi, emnuen Princ Wiedin per mbret të Shqypnis, i cili me 7 Marc 1914, erdhi në Durrëc e muer rejen e sundimit në dorë.

Po s'vonoj e Esad Toptani, ke dojte per fas-et-nefas me e ba Shqypnin të veten, shtini ngatrrasa e pshtjellime, e antarët e tij, qitën m'anesh nderen kombtare, permysen flamuri kombtar e në vend të tij u vu në vendin t'onë Turkija, e që prej Bregut të Matës e në Vlonë u fashit çëdo e mirë qi kje nisë e vetem mbi kshtjellin "Rozafat" valvitej enë flamurin kombtar. Per me ndalue ket shkandull, kishin rranë në ndihmë të mbretit, posë tjerve edhe Prengë Pasha me ma se 10.000 katolikë nder të cilët edhe shum djelm zotnish Shkodret, por kje e kotë, pse kryengritja kishte marrë teper të hapët, e pse ishte rrezik me shtue ma fort anmiqsin ndermjet të dy elementave.

Në ket kohë, P. Gjergj Fishta, per shkak të shkrimeve qi botojte në të perkohshmen "Hylli e Dritës", tuj qitë në shesh qellimet e t' interesuemve per ato ngatrrasa, kje dnue per mergim.

Kto pshtjellime e ky pabashkim vijoj se vijoj edhe gjith kohen e luftës europjane, e dymdhetë bajrakët e Mirditës e do të Pukës kjenë shkretnue prej esadistavet. Nder të gjitha ato luftime, pos sa burrave tjerë, Gjon Shkurt Lufi i Selitës e Pal Ndue Berhani i Pishkashit, i lanë nam vedit e bajrakut të vet per kreshniki qi diftuen.

Edhe bajrakve të Dukagjinit u tokoj në vjeten 1915 me psue shum. Të msym kta prej njaj ushtris së madhe të Malit të Zi u shtrenguen me qindrue. Lufta e bame në Qafen e Kolçit e ajo e Lugut të Shalës janë të rralla në historin t'onë. E para, pse një numer i vogel komite theu me dâm të madh ushtrin e madhe malazeze; dhe e dyta, pse shaljanët bân me ra në dorë 1500 ushtarë, e në shej robnijet me u pershkue të gjith nën armë. Para se të hijte ushtria malazeze në Shalë, Mehmet Shpendi bashkë me do kren i duel perpara ushtris per me u marrë vesht me ta, por kta per me ngushtue vendin mos me u vu pushken i mueren me vedi me hi

në Dukagjin. Mehmeti atëhere, megjithëse e dihte vedin e shokët të shkuem, u çoj lajmin bajrakve që mos të mendojshin për jetën e tyre, por të kryejshin detyrën tuaj mprojtë vendin prej të huejve, e ashtu ky me gjithë shokët e vet kje ba fli prej malazezve, posa krisën pushkët e para kundër tyre. Shpirti i ktyne dy luftave kjenë françeskaj P. Çiril Cani, famullitari i Shalës; P. Leonard Shajaku, famullitari i Nikajve; e P. Bernard Llupi, famullitari i Rajës, të cilët jo vetëm se nxiten popullin kundër Malit të Zi, por mueren pjesë, si komita, nder të msymet më të rrezikshmet.

Nuk është për ta qitë në harresë as aktivitetin e katolikve të Kosovës, ku s'bashkut me muhamedanë, nder çashtje kombtare, kjenë edhe ata me gjithë kler. Vepri-met e P. Kelmendit Miraj në Pejë e të Dom Shtjefen Krasniqit në Gjakovë enë nuk janë harrue. Nder katolikë të asajë krahinë u dan në shej kryetarët e komitës katolike: Zefi i Vogel, Pjeter Qeli, Pjeter Ramaja e Zef Gjin Doda. Atje u bân fli për atdhe, posë sa e sa katolikve, edhe dy françeskaj, P. Luigji Paliqi e P. Shtjefen Kostantini Gjeçovi.

Mbasi muer fund lufta europjane, u ba paqa, por kufijt e Shqypnis nuk ishin enë të siguruem. Propagandat e hueja ishin gjithnjë në kambë e u dojte guxim e therori për me i dhanë fund atij shkandulli të sa vjetve. Do shqyptarë të shitun slavit kishin ba parti e dojshin me ia lshue Serbis n' Ujë të Matës e perpjetë. Çeta serbjane perzietas me shqyptarë partizan të tyre kishin hi mrenda kufinit të Shqypnis e msyjshtin Shkodren. Para ktij mendimit të ri rranen muhamedanët e katolikët e Shkoders, e bashkue me malsorë, u kundërshtuen me armë në dorë derisa të e mbramja i shtyn përtej kufmit. Bashkë me popull luftoj kundër shkjaut edhe P. Çiril Cani, françeskan, e Dom Loro Caka. Ky i mbrami kje aj që kishte marrë pjesë edhe në të shumtën e levizjeve kombtare qësh në kohën e Turkut.

Vien me u dijt se edhe kúr në vjetin 1921 Mark Bozhi, nenprefekti i Gucis, kishte ba për vedi Dukagjinin e mendojte me msy Shkodren, fjala e Emzot Shllakut e e P. Çiril Canit bân me e zhgatrrue at bashkim që kishin pasë lidhë me Serbi.

Por për me sigurie kufijt e pamvarsin shqyptare nuk mjeftote vetëm arma, u dojte edhe penda. Edhe në ket pikë katolikët shqyptarë ia lanë dalë tjerve. Si prej viseve tjera të Shqypnis ashtu edhe prej krahinës së Shkoders, katolikë e muhamedanë, çojnë protestë mbas proteste në Lidhje të Komeve kundër atyne që dojshin me prekë në token shqyptare. Ma teper, ku në Lidhje të Komeve perflitej se nuk ishte mirë me e lanë Shqypnin shqimit të pamvarshme për shkak se tuaj pasë hegjemonin në dorë muhamedanët, nuk do të mujte me perparue ekonomisht e moralisht një shtet konstituejonal, kleri e populli katolik deklaruen, nepermjet Emzot Bumçit, që asokohet ishte kryetar i dergatës shqyptare për Konferencën së Paqes, se ata muhamedanët shqyptarë i mbajshin vllazen, e prandej me ta dojshin me e gzue Shqypnin. Kshtu edhe në vjetin 1921, kúr çohet një komisjon shqyptarësh katolikë e shkon në Gjenevë e lypë prej Lidhjes së Komeve, që

Shqypnija e Eperme - në Mat e perpjetë t'u qitëte kanton i pamvarshëm në vedi, kleri katolik më një protestoj telegrafisht kundra asaje kerkese edhe i deklaroj Lidhjes se Komeve se muhamedanin e mbajte vlla për kahe komsija e politikisht. Ket deklarate e banin edhe në vjeten 1923 kúr njëfare Lambertit lypte prej Lidhjes se Komeve, që Shqypnija të dahej e të qeverisej në kantone.

Perfundojme për shka u shenjue deri ktu, se kleri e populli katolik kjene një nder ma të parët faktore moral të ndertimit të shtetit shqyptár. Kta e kryen ma se mirrit detyren e vet për atdhen, a bân fli interesat e veta, ma se një here, për nderen e komit e për të mirën e përbashket.